



Zyra e Kryetarit të komunës
Nr.02/Zyrtarisht
Datë: 18.12.2018

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nr. 370/2018, datë: 05.12.2018, Nr. Prot. 7578/2018, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, neni 13, Statutit të Komunës neni 55, pika 20, si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, mori këtë:

VENDIM

I

Për zbatimin e vendimit: Nr. 370/2018, të datës: 05.12.2018 Nr. Prot. 7578/2018, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku sipas këtij vendimi anulohet procedura **si e pa rregullt**, në procedurën e rekrutimit për pozitën e punës: Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm, në Komunën e Deçanit.

II

Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, zbatohet menjëherë dhe konsiderohet i ekzekutueshëm, nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Deçanit, ku dhe vendoset që procedura paraprake e rekrutimit për pozitën e punës: Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm, është e anuluar si dhe të fillohet me procedurën e rekrutimit për shpallje të Konkursit Publik për të njëjtën pozite pune.

III

Ky vendim hyn në fuqi, menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim njoftohen:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
Zyra e Personelit;
Kandidatet të cilët kane qene në procedurë të rekrutimit dhe
Arkivi i komunës.

KRYETARI I KOMUNËS REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DEÇANI MUNICIPALITY	
Udhë: 00:	30127
From:	Prot. No
Nr. i kopjeve: Si Shprehje: No Pages:	02
	Data: 18.12.18



Kryetari i komunës

Bashkim RAMOSAJ